

Rrugët rurale, 400 milionë USD për 1500 kilometra

Investimet në infrastrukturën rrugore vitin e ardhshëm do të shtrihen edhe në akset dytësore dhe lokale. Kjo nismë ka qenë dje në qendër të një takimi ndërmjet përfaqësuesve të qeverisë shqiptare, Bankës Botërore dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit. Përmasat e parashikuara të projektit do të përfshijnë 1000 deri në 1500 kilometra rrugë dytësore për riparimin e të cilave nevojiten 200-400 milionë dollarë amerikanë. Ky projekt është nismë e qeverisë shqiptare i mbështetur nga BB dhe që do të realizohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Në fund të këtij projekti, i cili do të zgjasë 5 vjet, parashikohet të ngrihet jo vetëm një rrjet dytësor dhe komunal i përmirësuar në mënyrë rrënjësore, por edhe një inventar i rifreskuar i të gjitha rrugëve rajonale, duke mundësuar njohjen në kohë reale të nevojave për investim dhe për mirëmbajtjen e tyre, tha zv/kryeministri Gazmend Oketa.

Drejtori Ekzekutiv i Fondit Shqiptar të Zhvillimit, Benet Beci, tha se lidhja e kontrat-



Gjatë punimeve në një rrugë rurale

Ruralet, 95% në kushte të këqija

Në zonat rurale të Shqipërisë jeton më shumë se gjysma (55%) e popullsisë, dhe një pjesë e saj është e varfër. Një vëzhgim i fundit i Bankës Botërore ka

vënë në dukje se, pas punësimit dhe nivelit të të ardhurave që janë të parat, shumica e të anketuarve kanë konsideruar problemet e infrastrukturës si faktorë kryesorë që ndikojnë në standardin e tyre të jetesës. Banorët e zonave rurale kanë vënë në dukje gjithashtu faktin se aksesit i pamjaftueshëm në infrastrukturën rrugore krijon për ta vështirësi drejt tregjeve të shitjes, kontribuon në migrimin e popullsisë drejt zonave urbane, dhe është pengesë për realizimin e shërbimeve shëndetësore dhe arsimit.

ave të para të punimeve civile pritet të bëhet në periudhën korrik-qershor 2008. I gjithë projekti do të zbatohet në bashkëpunim të ngushtë me Njësitë e Qeverisjes Vendore. Sipas Becit, kriteret kryesore për përzgjedhjen e projekteve për financim do të përfshijnë: "ndikimin e projektit në zhvillimin social e ekonomik të zonës, gjendja ekzistuese e

rrugës së propozuar, numri i përfituesve, raporti financiar kosto/përfitim etj.". Kriteret do të bëhen publike para vlerësimit dhe do të konsultohen me të gjithë të interesuarit, në mënyrë që të arrihet një përzgjedhje sa më e mirë e projekteve për financim.

Projekti i propozuar do të ketë komponentë kryesorë, përmirësimin e seksioneve prioritare të rrjetit rrugor rajonal dhe përmirësimin e seksioneve prioritare të rrjetit rrugor në komuna. Përfaqësuesi i Bankës Botërore, Richard Martin Hamphrey, përgjegjës për transportin tha se, kontributi i BB për këtë projekt është një kredi e IBRD prej 20 milionë dollarësh amerikanë. Ai tha se, megjithatë është diskutuar dhe rënë dakord paraprakisht bashkëfinancimi i projektit me një numër institucioneve të tjera financiare.

39%

e rrjetit rrugor lokal është i asfaltuar

95%

e tij është në kushte të këqija

Rreth 49 për qind prodhuesve agrarë kanë deklaruar se mungesa e infrastrukturës së mirë rrugore përbën problemin kryesor në tregtimin e produkteve të tyre.

Aktualisht, vetëm 39 për qind e rrjetit rrugor lokal është i asfaltuar, që është dhe shifra më e ulët në rajon, dhe 95% e tij është në kushte të këqija ose shumë të këqija – me segmente rrugore që janë të pakalueshme në pjesën më të madhe të vitit. Të ardhurat në nivelin lokal, si taksa e regjistrimit të automjeteve, janë të pamjaftueshme për të realizuar mirëmbajtjen e rrugëve në nivelin e kërkuar – shpenzimet aktuale të mirëmbajtjes përbëjnë vetëm 40% të atyre që do të duheshin për të.

KURUM STEEL

PER TE GJITHA

KURUM INTERNATI

Hekur me cilësi të lartë të Standarteve Europiane B

51

Kompania KURUM garanton:

- ❖ Cilësinë e produkteve të saj
- ❖ Çmimin më të mirë në treg
- ❖ Lehtësira në pagesa
- ❖ Llojshmerine e te gjitha pro
- ❖ Transportin brenda 24 orëve

VEPR

Për më shumë informac

+355 4 280 17

Email: infoalbania@kurum.com.tr